



Departamenti i Problemeve të Krimin  
Drejtoria e Përgjithshme I - Çështjet Ligjore

## Zbatimi i Planeve Anti-korrupsion në Evropën Juglindore

### (PACO IMPACT)

– përmbledhje e projektit –

Titulli i projektit	Zbatimi i projekteve anti-korrupsion në Evropën Juglindore (PACO IMPACT)
Zona e projektit	Evropa Juglindore: Shqipëria, Bosnia dhe Hercegovina, Kroacia, "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë", Serbia dhe Mali i Zi [duke përfshirë dhe Kosovën]
Buxheti	EURO 1.5 milion
Financimi	Agjensia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim
Zbatimi	Këshilli i Europës (Departamenti i Problemeve të Krimin – Çështjet Ligjore)
Kohëzgjatja	24 muaj (1 Mars 2004 – 28 Shkurt 2006)

### HISTORIKU DHE JUSTIFIKIMI

Nevoja për ta adresuar korrupsionin dhe krimin e organizuar si një pengesë për stabilitetin demokratik, shtetin e së drejtës dhe zhvillimin ekonomik dhe atë social në Evropën Juglindore, është ngritur në shumë raste nga Këshilli i Europës dhe organizata të tjera. Vendet e Evropës Juglindore kanë ndërmarrë këtë sfidë dhe kanë bërë progres për sa i përket adoptimit të standarteve europiane dhe legjislacionit përkatës, marrjen pjesë në mekanizmat ndërkombëtar të monitorimit (Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit – GRECO), përpunimin e planeve të veprimit anti-korrupsion dhe ngritjen e strukturave të specializuara anti-korrupsion.

Ky projekt do të mbështesë vendet e Evropës Juglindore në përpjekjet e tyre anti-korrupsion dhe në mënyrë të veçantë në zbatimin e planeve dhe strategjive anti-korrupsion.

Eksperienca tregon se strategji të tilla kanë më shumë mundësi për të qenë të suksesshme nëse ato përmbajnë tre elementë, të cilët janë ngushtësisht të lidhur me njëri-tjetrin:

- Zbatimi i legjislacionit
- Parandalimi
- Ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e publikut në përpjekjet anti-korrupsion.

Në lidhje me projektin në fjalë, është veçanërisht me vlerë, eksperienca e fituar gjatë projektit PACO Albania (që prej vitit 2001).

Projekti do të ecë në vazhdim të vlerësimeve të kryera nën Iniciativën Anti-korrupsion të Paktit të Stabilitetit (SPAI) si dhe të rekomandimeve të dala nga vlerësimet e GRECO-s. Gjithashtu, pritet që ky projekt të ndihmojë si në procesin e SPAI-t dhe në atë të GRECO-s. Për më tepër, do të bazohet në zotimet e marra nga vendet e Evropës Juglindore në Konferencën Ministrore mbi Krimin e Organizuar në Londër (nëntor 2002) si dhe duke pasur parasysh masat anti-korrupsion të identifikuara gjatë procesit të Asociim-Stabilizimit.

Është e rëndësishme të theksohet se Komisioni Evropian (KE) do të mbështeti zbatimin e këtyre zotimeve, midis të tjerash dhe përmes programit CARDS. Në nëntor 2003, KE financoi projektin rajonal CARDS për forcimin e kapaciteteve të policisë kundër krimeve të rënda në Evropën Juglindore, i cili iu dha një konsorciumi të udhëhequr nga Këshilli i Europës. Projekti CARDS për policinë dhe projekti PACO IMPACT do të menaxhohen në një mënyrë të tillë që të jenë komplementarë me njëri-tjetrit.

## **OBJEKTIVI, REZULTATET DHE AKTIVITETET**

<b>Objektivi afatgjatë:</b>	Forcimi i demokracisë dhe shtetit të së drejtës në Evropën Juglindore përmes parandalimit dhe kontrollit të korrupsionit
<b>Objektivi i projektit:</b>	Të kontribuojë në zbatimin (dhe përpunimin e mëtejshëm) e planeve anti-korrupsion në vendet e Evropës Juglindore
<b>Rezultati 1:</b>	<b>Plane anti-korrupsion të përmirësuara ose përpunuara</b>
Aktivitetet:	<ul style="list-style-type: none"><li>Në çdo shtet, takime me grupe pune, workshope dhe trajnime, këshillime për të përmirësuar ose përpunuar dhe bërë funksionale planet anti-korrupsion (duke përfshirë standarte të qarta, tregues dhe caktime detyrash dhe reflektim të një balance midis zbatimit të ligjit, parandalimit dhe ndërgjegjësimit/përfshirjes së publikut)</li><li>Seminaret rajonale për të bërë të mundur një rishikim të përbashkët të planeve anti-korrupsion dhe shkëmbim të eksperiencave (në mbështetje të qëllimeve të SPAI-t)</li></ul>
<b>Rezultati 2:</b>	<b>Mekanizmat institucional për monitorimin dhe menaxhimin e planeve të forcuar anti-korrupsion</b>
Aktivitetet:	<ul style="list-style-type: none"><li>Këshillim mbi bazën ligjore, detyrat, strukturat organizative dhe menaxhimin e institucioneve anti-korrupsion</li><li>Trajnime i stafit dhe këshillim për këto institucione</li><li>Dhënia e pajisjeve bazë për këto institucione (nëse është e nevojshme)</li><li>Lehtësimi i shkëmbimit të eksperiencave dhe krijimit të rrjeteve midis institucioneve anti-korrupsion (në mbështetje të qëllimeve të SPAI-t)</li></ul>
<b>Rezultati 3:</b>	<b>Draft ligjet/ndryshimet e mundshme për ta sjellë legjislacionin penal për korrupsionin në një nivel me standartet evropiane</b>
Aktiviteti:	<ul style="list-style-type: none"><li>Mbështetje për rishikimin e legjislacionit penal</li><li>Kryerja e opinionëve ligjore</li><li>Mbajtja e workshopeve/trajnimeve për të diskutuar dhe finalizuar draft ligjet të cilat do të paraqiten qeverisë</li></ul>
<b>Rezultati 4:</b>	<b>Aktivitetet pilot që do të mbështeten</b>
Aktiviteti:	<ul style="list-style-type: none"><li>Në çdo zonë të projektit do të mbështetet zbatimi i një numri të kufizuar aktiviteteve të cilat janë prioritare dhe kanë impakt, aktivitete të cilat mund të shërbejnë si shembuj ose do të ndihmojnë për të krijuar një momentum</li><li>Seminare rajonale për të pasur akses në praktikat më të mira dhe shpërndarjen e eksperiencës së fituar në vende të tjera.</li></ul>

Projekti, duke pasur parasysh nevojat specifike në çdo zonë të projektit, do të përmbajë një element të fortë të ndërveprimit rajonal si dhe do të lehtësojë shkëmbimin e eksperiencave dhe krijimin e rrjeteve midis institucioneve anti-korrupsion.

## **PARTNERËT**

Veçanërisht, në çdo zonë të projektit, aktivitetet do të përfshijnë institucionet partnere të mëposhtme:

- Shqipëria: Grupi i Monitorimit Anti-korrupsion (GMAK), Ministria e Drejtësisë dhe Prokuroria e Përgjithshme
- Bosnia dhe Hercegovina: Grupi i Punës për korrupsionin në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Gjykata Shtetërore, Prokuroria Publike Shtetërore, Ministria e Drejtësisë dhe Prokuroritë Publike në nivel entiteti
- Kroacia: USKOK, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Brendshme
- “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”: Komisioni Shtetëror Anti-Korrupsion, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, grupi i prokurorëve të specializuar në çështjet e korrupsionit dhe krimin të organizuar
- Serbia: Zyra Anti-korrupsion në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financës, Këshilli Anti-korrupsion, skuadrat anti-korrupsion, Ministria e Brendshme, Prokuroria
- Mali i Zi: Agjensia Anti-korrupsion (AAK), Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Prokuroria
- Kosova: Grupi Ndërmintor kundër Korrupsionit i Qeverisë së Kosovës, Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Kryeministrit të Kosovës, Këshilltari Ligjor i Zyrës së UNMIK-ut dhe Departmenti i Drejtësisë i UNMIK-ut.

## **MËNYRA E ZBATIMIT**

Projekti do të zbatohet nga Departamenti i Problemeve të Krimin të Drejtorisë së Përgjithshme për Çështjet Ligjore të Këshillit të Evropës. Departamenti do të sigurojë bashkërendimin dhe integrimin me standartet e vendosura, monitorimin dhe aktivitetet e tjera të bashkëpunimit teknik, si dhe me Iniciativën Anti-korrupsion të Paktit të Stabilitetit (SPAI).

Ne çdo vend, qeveria do të emërojë një drejtor projekti, i cili - së bashku me organin kryesor zyrtar anti-korrupsion – do të jenë interlocutori kryesor për Këshillin e Evropës në zbatimin e këtij projekti.

Gjithashtu, një drejtues lokal projekti do të rekrutohet nga Këshilli i Evropës në çdo vend të rajonit, me qëllim që të mbështesi çdo ditë institucionet partnere. Projekti do të mbështetet në zyrat e Këshillit të Evropës në Beograd, Podgoricë, Prishtinë, Sarajevë, Shkup dhe Tiranë.

Një skuadër ekspertësh dhe konsulentësh do të krijohet për t'i dhënë projektit inpute afat-shkurtra. Në mënyrë që të fuqizohen lidhjet me si dhe të përfitohet nga eksperiencia e organeve anti-korrupsion në vendet e tjera evropiane, do të kërkohet bashkëpunimi me organe të tilla.

## **KONTAKT**

Për çdo informacion shtesë ju lutemi të kontaktoni:

Departamentin e Problemeve të Krimin/Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Ligjore/Këshilli i Evropës  
F-67075 Strasbourg Cedex (Francë)

Tel +33 3 8841 2354 Fax +33 3 8841 3955 Email: [ardita.abdiu@coe.int](mailto:ardita.abdiu@coe.int)

**Version i 25 shkurtit 2004**